



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 251/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.04.2019 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** “Shfuqizim i vendimit të autoritetit kontraktor në lidhje me skualifikimin e shoqërisë “Nika” sh.p.k në procedurën e prokurimit me Nr.REF-00383-12-19-2018, me objekt: Loti II: “*Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin e Ndërhyrjes së Shpejtë Shkodër*”, “*Marrëveshje kuadër*”, me fond limit 29.612.366 lekë pa tvsh, zhvilluar ne daten 21.01.2019 nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.”
- Ankimues:** “Nika” sh.p.k
Rruga Bulevardi Skenderbeg, pas Kinema Millenium-Shkodër
- Autoriteti Kontraktor:** Agjencia e Blerjeve të Përqendruara
Sheshi Skënderbej, nr. 3, Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 20.12.2018 është publikuar nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr.REF-00383-12-19-2018, me objekt: Loti II: “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin e Ndërhyrjes së Shpejtë Shkodër”, “Marrëveshje kuadër”, me fond limit 29.612.366 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 21.01.2019 nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 18.02.2019 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar si më poshtë:

1. “Nika” sh.p.k	23.197.530,00 lekë, skualifikuar
2. “Nelsa” sh.p.k	24.339.447,00 lekë, skualifikuar
3. “Dajti Park 2007” sh.p.k	27.072.215,00 lekë, skualifikuar
4. “Shpresa” sh.p.k	27.738.183,60 lekë, kualifikuar
5. “Alar Food & Service” sh.p.k	28.080.450,00 lekë, skualifikuar
6. “Silver” sh.p.k	29.034.000,00 lekë, skualifikuar

Operatori ekonomik “Nika” sh.p.k rezulton i skualifikuar nga KVO-ja me argumentin e mëposhtëm:

“• Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 1(c) të seksionit 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” të dokumenteve të tenderit, pasi deklarata e paraqitur nga ana e tij nuk është në përputhje me standartin e përcaktuar në DST, shtojca nr 6, “Dekleratë mbi konfliktin e interesit” (i mungojnë pjesë).

• Bazuar dokumentacionit të dorëzuar nga ofertuesi për të provuar pasjen e numrit të punonjësve të kualifikuar, sipas profesioneve në tabelën e pikës 6, të kapacitetit Teknik në DT, ekzistencën e tyre në

listëpagesat për periudhën e kërkuar janar-dhjetor 2018 dhe pasjen e dokumentacionit përkatës për secilin punonjës sipas pikës 5, të kapacitetit Teknik në DT (kontrate pune, libreze pune, librezë shëndetsore, diplomë ose certifikatë kualifikimi), pas shqyrtimit e vlerësimit të përputhshmërisë së dokumenteve të dorëzuar me ato të kërkuar në dokumentat e tenderit, rezulton se ato nuk përputhen me kodet e profesioneve në listëpagesat për periudhën e kërkuar, bazuar në VKM nr.514 datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve”, pra ofertuesi nuk e përmbush kapacitetin teknik të kërkuar në DT. Konkretisht nga 18 persona të kërkuar si ndihmes kuzhinier, të rregullt sipas listëpageses (kodit) janë vetëm 6 persona.”

II.3. Në datën 22.02.2019 operatori ekonomik “Nika” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij në procedurën e prokurimit. Konkretisht pretendohet se:

“Së pari; Në lidhje me pretendimin se s’përmbushim kriterin e punonjësve të shërbimit të kërkuar nga AK, sqarojmë se këtë kriter e përmbushim madje me numër punëtorësh edhe më shumë se sa është kërkuar nga ana e AK. Po të verifikohet listëpagesa e muajit dhjetor 2018 që tregon gjendjen aktuale të numrit të punëtorëve të shërbimit, rezulton se kemi të punësuar 23 të tillë edhe 5 më shumë se sa janë kërkuar nga AK. Sqarojmë se këta 23 punonjës janë të shoqëruar me të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ana juaj, konkretisht me kontratë pune, libreza pune dhe libreza shëndetësore dhe të deklaruar ekzaktësisht në listpagesa me kodin përkatës të kërkuar nga ana juaj.

Së dyti; në lidhje me pretendimin se deklarata mbi konfliktin e interes nuk është sipas formatit të DST, pasi mungojnë pjesë, sqarojmë se kjo nuk është e vërtetë pasi është tekstualisht sipas kërkesave tuaja dhe sipas formatit standard të vendosur në DST. I vetmi ndryshim është se dokumenti është paraqitur me shkrim më të vogël se sa ai i vendosur në DST, por përmbajtja është identike. [...]”

II.5. Nëpërmjet shkresës Nr.395/1 Prot., datë 28.02.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit, duke e refuzuar ankesën, si vijon:

“[...] Duke u bazuar në dokumentat e dorëzuara nga ofertuesi për të provuar pasjen e numrit të punonjësve të kualifikuar, sipas profesioneve në tabelë dhe ekzistencën e tyre në listpagesat për periudhën e kërkuar janar 2018-dhjetor 2018 dhe pasjen e dokumentacionit përkatës për secilin punonjës të kërkuar në DT (kontratë punë, librezë pune, librezë shëndetësore, diplomë ose certifikatë kualifikimi), pas shqyrtimit e vlerësimit të përputhshmërisë së dokumentave të dorëzuar me njëri tjetrin, rezulton se ato nuk përputhen me kodet e profesioneve në listpagesat për periudhën e kërkuar, bazuar në VKM nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve”, pra ofertuesi nuk e përmbush kapacitetin teknik të kërkuar në DT. Përsa i përket pretendimit të ofertuesit se janë 23 punonjës në listpagesën e muajit dhjetor, sqarojmë se kërkesa për 20 punonjës në total ku përfshihen 18 ndihmës kuzhinier/shërbyes gatimi, 1 mercolog dhe 1 kuzhinier, janë kërkuar se duhet të figurojnë në listpagesat e operatorit ekonomik për periudhën e kërkuar, ku periudha e kërkuar është janar 2018-dhjetor 2018 dhe ofertuesi nuk disponon në bazë të kodeve të profesioneve, numrin e kërkuar në DT të punonjësve në listpagesat për periudhën janar 2018-dhjetor 2018.

Lidhur me deklaratën mbi konfliktin e interes, u konstatua se deklarata nuk është e paraqitur si kërkohet në shtojcën 6, pasi është modifikuar dhe i mungojnë disa pjesë të deklaratës, më konkretisht: “Gjyqtarët e prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit ... dhe Konfliktit të Interesave ... titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil ...”, duke sjellë

mospërputje me standardin e përcaktuar në dokumentat e tenderit dhe në të njëjtën kohë, duke hedhur poshtë pretendimin e operatorit se kemi të bëjmë me të njëjtën deklaratë por me shkrim të vogël.”

II.6. Në datën 13.03.2019 operatori ekonomik “Nika” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor, si dhe duke kundërshtuar argumentat e dhëna në përgjigjen e AK-së.

II.7. Në datën 26.03.2019 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 452/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 528/1 prot., datë 25.03.2019, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Nika” sh.p.k se: *“Bazuar dokumentacionit të dorëzuar nga ofertuesi për të provuar pasjen e numrit të punonjësve të kualifikuar, sipas profesioneve në tabelën e pikës 6, të kapacitetit Teknik në DT, ekzistencën e tyre në listëpagesat për periudhën e kërkuar janar-dhjetor 2018 dhe pasjen e dokumentacionit përkatës për secilin punonjës sipas pikës 5, të kapacitetit Teknik në DT (kontrate pune, libreze pune, librezë shëndetsore, diplomë ose certifikatë kualifikimi), pas shqyrtimit e vlerësimit të përputhshmërisë së dokumenteve të dorëzuar me ato të kërkuar në dokumentat e tenderit, rezulton se ato nuk përputhen me kodet e profesioneve në listëpagesat për periudhën e kërkuar, bazuar në VKM nr.514 datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve”, pra ofertuesi nuk e përmbush kapacitetin teknik të kërkuar në DT. Konkretisht nga 18 persona të kërkuar si ndihmes kuzhinier, te rregullt sipas listepageses (kodit) jane vetem 6 persona”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pikat 11, 12, 13 të dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit, nga ana e autoritetit kontraktor rezulton se është kërkuar plotësimi i kapaciteteve si më poshtë vijon:

11. *Operatori ekonomik duhet të ketë jo më pak se 20 (njëzetë) persona të punësuar në sektorin e shërbimit të ushqimit, të siguruar për periudhën janar 2018 – dhjetor 2018. Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë:*

- *Një vertetim nga administrata tatimore për numrin mesatar te punonjësve për periudhën janar 2018 - dhjetor 2018.*
- *Listepagesat (E-Sig 025) te konfirmuara nga Administrata Tatimore për periudhën janar 2018 - dhjetor 2018.*

12. *Për punonjësit me profesione si në tabelën e mëposhtme Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:*

- a) Për kuzhinierin: diplome ose çertifikatë kualifikimi, kontrate pune, libreze pune, librezë shëndetsore.
- b) Për mercollogun/kimistin/teknologun: diplomë ose çertifikatë kualifikimi, kontrate pune, libreze pune, librezë shëndetsore.
- c) Për ndihmës kuzhinierë/Sherbyes gatimi: kontrata pune dhe librezat e punes, librezë shëndetsore.
- d) Punonjësit e mëposhtëm duhet të figurojnë në listpagesat e operatorit ekonomik për periudhën e kerkuar.

13. Punonjësit duhet të kenë minimalisht 1 vit eksperiencë pune sipas profesioneve në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Profesioni	Numri i punonjesve
1	Kuzhinier	1
2	Mercollog/Kimist/teknolog	1
3	Ndihmes kuzhinierë/Sherbyes gatimi	18
	Total	20

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të shoqërisë “Nika” sh.p.k, konstatohet se për përmbushjen e kriterit për 18 Ndihmes kuzhinierë/Sherbyes gatimi, kjo shoqëri ka paraqitur dokumentacionin si vijon:

1. Vërtetim lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve DTM, datë 19.01.2019 për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për tatimpaguesit – E-SIG 02/a, për personin juridik/fizik “Nika” sh.p.k. në të cilën jepet informacion, për numrin e punonjësve për periudhën janar 2018 - dhjetor 2018.
2. Listpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi për periudhën tatimore janar 2018 - dhjetor 2018, për shoqërinë “Nika” sh.p.k.
3. Kontrata pune dhe librezat e punes, librezat shëndetsore për ndihmës kuzhinierë/Sherbyes gatimi.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1/b, të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.1.4. Në nenin 55, pika 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet 2. Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.

III.1.5. Neni 28, pika 5, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se :

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla;dhe/ose*
- c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose*
- ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

III.1.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kapaciteteve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor, do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit në respekt të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi. KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.7. Referuar sa më sipër KPP konstaton se në kriteret kualifikuese autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatorët ekonomikë të dëshmojnë me dokumentacion provues se disponojnë 18 ndihmës kuzhinierë/Sherbyes gatimi, (me kontrata pune, librezat e punes, librezë shëndetsore) të cilët të kenë minimalisht 1 vit eksperiencë pune sipas profesioneve dhe të jenë të siguruar për periudhën janar 2018 – dhjetor 2018 Në rastin konkret, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Nika” sh.p.k rezulton se shoqëria në fjalë ka paraqitur listpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi për periudhën tatimore janar 2018 - dhjetor 2018. Sipas këtyre listpagesave rezulton se operatori ekonomik “Nika” sh.p.k disponon për muajin dhjetor, 6

punonjës me profesionin “ndihmës kuzhinierë/Sherbyes gatimi”, të deklaruar nga ankimuesi në këto listpagesa, sipas kodeve 9411 dhe 9412 të profesioneve, referuar VKM nr. 514, datë 20.09.2017 “*Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve*”, ndërsa për muajt e tjerë, ku numër është edhe më i vogël.

Në këto kushte KPP gjykon se operatori ekonomik ankimues nuk ka plotësuar njërin nga pikat e kriterit të kualifikimit i cili kërkon shprehimisht që punonjësit ndihmës kuzhinierë/Sherbyes gatimi duhet të figurojnë në listpagesat e operatorit ekonomik për periudhën e kerkuar janar 2018 - dhjetor 2018. Pretendimin e ankimuesit se është plotësuar kriteri i kualifikimit pasi në muajin dhjetor 2018 ka 23 punonjës me kualifikimin e kerkuar, KPP e gjen të pabazuar, pasi për këtë muaj me kodet përkatëse figurojnë në listpagesa vetëm 6 punonjës me kodin 9412.

III.1.8. Komisioni sqaron se nëse operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës lidhur me kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar parashikohet se “*Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni*”. Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuesë. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, parashikohet se “*[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]*”.

Sa më sipër pretendimet e ankimuesit “Nika” shpik nuk qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ankimuesit përse i përket skualifikimit të tij të padrejtë nga ana e autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik, referuar gjykimit të dhënë në pikën III.1 të arsyetimit, vlerëson se këto pretendime nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative pasi, gjendja faktike dhe juridike e këtij operatori ekonomik do të vijojë të ngelet e skualifikuar edhe pas ankimit në KPP, duke mos pasur më interes të ligjshëm në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Nika” sh.p.k për procedurën e prokurimit me Nr.REF-00383-12-19-2018, me objekt: Loti II: “*Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin e Ndërhyrjes së Shpejtë Shkodër*”, “*Marrëveshje kuadër*”, me fond limit 29.612.366 lekë pa tvsh, zhvilluar ne daten 21.01.2019 nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Nr. 452 Protokolli,

Datë 13.03.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha